



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:045454

Datë: 02.07.2024

Numri i dokumentit: 05883789

P.nr.2022:045454

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC/Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me Bashkëpunëtorin profesional Afrim Gashi, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit L.B nga fshati Brestoc, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Gjakovë/Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.16/2022 të datës 25.04.2023, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar dhe publik, në prezencën e përfaqësuesit të akuzës Prokurori i Shtetit Uridia Caka dhe të akuzuarit, më datë 11.06.2024, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

L.B, nga i ati B, e ëma R, e lindur M, i lindur më datë në fshatin Brestoc, Komuna e Rahovecit ku edhe banon, me numër personal i martuar i ati i tre (3) fëmijëve, ka të kryer shkollën e filllore,i pa pun, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S E P S E

Me datë 28.12.2021, rreth orës 09:30, n; fshatin Brestoc, Komuna e Rahovecit, i pandehuri në shtëpinë e tij, iu shkakton lëndime trupore personit tjetër, këtu të dëmtuarve Sh dhe A.E, në atë mënyrë që si rrjedhojë e një mosmarrëveshje të mëparshme që kishin mes vete për shkak pakënaqësisë së të pandehurit rreth punës së të dëmtuarve, gjatë instalimit të ngrohjes qendrore në shtëpinë e tij, ashtu që I pandehuri ditën kritike I kishte ftuar të dëmtuarit në shtëpinë e tij për të bërë ndryshime në instalimin e nxemjes qendrore dhe derisa të dëmtuarit ishin duke e bërë punën e tyre, I pandehuri fillon të bërtet me zë të lartë duke I kritikuar dhe ofenduar te demtuarit, ku për një moment I pandehuri e sulmon fizikisht të dëmtuarin Sh duke e goditur dy here me grusht në fytyrë, ku aty ndërhyjnë I dëmtuari A, ashtu që I pandehuri e sulmon fizikisht edhe të dëmtuarin A duke e goditur me grusht në fytyrë, me ç’rast të dëmtuarve iu shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin dhe atë gjakmbledhje nën lëkurore rreth syrit të majtë, të përshkruara sipas ekspertizës mjeko ligjore të Dr.B.C, të dates 11.02.2022.

- Këso dore ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 6, 7, 17, 38, 39, 40 par. nënpar.1.1, 43, 69, 70, 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, dhe nenit 364 të KPPK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME GJOBË në shumën prej katërqind (400) Euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, atëherë të akuzuarit dënimin me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë (10) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) €.

I dëmtuarit Sh dhe A E , që të dytë nga fshati Brestoc, Komuna e Rahovecit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Detyrohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej tridhjetë (30) Euro si dhe në emër të kompensimit për viktimat e krimit shumën prej njëzet (20) Euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.16/2022 të datës 25.04.2023, kundër të akuzuarit L.B, nga fshati Brestoc, Komuna e Rahovecit për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 11.06.2024, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Uridia Caka, i akuzuari L.B me mbrojtësin e tij av. B.O, ndërsa nuk ka qenë prezent i dëmtuari, për të cilën gjykata nuk ka provë se është ftuar në kohë dhe në mënyrë të rregullt.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i cili ka qëndruar në tërësi pranë saj, i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë e pranimit ose mospranimit të fajësisë, si dhe gjykata e ka njoftuar lidhur me efektet dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

I akuzuari L.B ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, e ndien veten fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet dhe se ndien keqardhje për rastin që ka ndodhur. Me të akuzuarin e dytë i kanë rregulluar raportet, është penduar për veprimin e bërë i premtoj gjykatës së një veprim i tillë nuk do të përsëritët.

Mbrojtësi i të akuzuarit – avokati B.O ka deklaruar se: meqenëse i mbrojturi i tij pranon fajësinë, i propozoj gjykatës që me rastin e vlerësimit dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit eventual të ketë parasysh rrethanat lehtësuese të cilat kanë ndodhur ngjarja duke qenë se i pandehuri L.B ka qenë në pronën e tije por që me ndërmjetësimin e personave të tjerë palët janë pajtuar dhe nuk kanë probleme mes veti kështu që i propozojmë gjykatës që të shqiptoj një dënim sa ma të butë.

Prokurorja e Shtetit Uridia Caka jep mendimin lidhur me pranimin e fajësisë e cila ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet të lirë dhe pasi i ka kuptuar të drejtat, respektivisht favoret dhe pasojat e pranimin të fajësisë, po ashtu duke marrë për bazë se aktakuza ka mbështetje në provat materiale dhe personale në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike në dispozitiv të saj, ku edhe përmbushen të gjitha elementet e veprës penale për të cilat ngarkohet i akuzuari. I propozoj gjykatës që i akuzuar të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet një dënim i paraparë ligjor duke pasur parasysh shkallen e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së veprës penale për të cilën ngarkohet. Gjithashtu me rastin e vlerësimit dhe caktimit të dënimit të ketë parasysh edhe qëllimin e dënimit duke i vlerësuar rrethanat lehtësuese, pranimin e fajësisë në këtë shqyrtim gjyqësor, pendimin e tij, premtimin se ne te ardhmen nuk do të kryej ndonjë vepër penale ndërsa si rrethana rëndësues te ketë parasysh dashjen e tij në kryerjen e veprës penale, rrethanat në të cilat e ka kryer veprën penale si dhe faktin se veprën penale e ka kryer ndaj dy të dëmtuarve. Gjykata konform dispozitave të nenit 364 të KPPK-së, e pasi që janë plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave të nenit 322 të njëjtit Kod, për shkak se i akuzuari në fillim të seancës të shqyrtimit fillestar është deklaruar i fajshëm, në tërësi ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata nuk është lëshuar në procedurën e administrimit të provave.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: - se i akuzuari L.B, me dashje ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK- së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale lëndim i lehtë trupor e kryen: "**Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton me : dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.**

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas pranimin të fajësisë nga i akuzuari, ka gjetur se i njëjti ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar 1.4 të KPRK – së, dhe gjendjen e tillë faktike e mori ashtu sikurse ishte përcaktuar në aktakuzë dhe provat materiale të cilat i përmbante aktakuza, e të cilat janë:

-Raporti i policit R.B, datë 28.12.2021;

- Ekspertiza mjekoligjore e Dr.N;
- Deklarata e të dëmtuarit A E e dhënë në Prokurori me datë 13.05.2022;
- Deklarata e të dëmtuarit/pandehurit Sh.E e dhënë në Prokurori me datë 30.12.202;
- Deklarata e të dëmtuarit/pandehurit L.B dhënë në Prokurori me datë 13.05.2022;
- Foto dokumentacioni në shkresat e lëndës;

Prandaj në bazë të këtyre provave dhe vetë pranimit të fajësisë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit, gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka marrë sjelljen korrekte të të akuzuarit në gjykim, është penduar për veprimin e bërë, është hera e parë që ndeshet me ligjin, i njëjti është deklaruar i fajshëm, se i vjen keq për rastin e ndodhur, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë një veprim të tillë, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit ia ka shqiptuar dënimin me gjobë me shpresë dhe bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit që kërkesën pasurore – juridike ta realizojë në procedurën e rregullt civile bazohet në nenin 462 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor bazohet në nenin 452 par.1 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në kuptim të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.05/L – 036, për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lartë, e në vështrim të nenit 364 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.2022:045454 me datë 11.06.2024

B. Profesional
Afrim Gashi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Mizahir Shabani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit, nëpërmjet kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.